



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË

Mesazhi i Ministrit



Shpreh bindjen time se ky dokument i parë, i Planit të Integruar të Ministrisë së Shëndetësisë, do të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për zbatimin dhe ndjekjen e aktiviteteve në Sektorin e Shëndetësisë dhe do të përmirësojë dukshëm mënyrën e menaxhimit të këtij sektori duke e transformuar atë në një sistem menaxhimi bashkëkohor, e të krahasueshëm me atë të vendeve të zhvilluara evropiane.

Nard Ndoka

Ministër i Shëndetësisë

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	3
3	Programet buxhetore të Ministrisë	4
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	5
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	9
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	10
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë	11
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin European	13
Aneks 4	Investimet publike	14
Aneks 5	Projekte të ndihmës së huaj	15

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Shëndetësisë ka për mision hartimin dhe është përgjegjëse për zbatimin e politikave e strategjive të zhvillimit në sistemin shëndetësor, për rregullimin e tij si dhe për koordinimin e të gjithë aktorëve brenda dhe jashtë sistemit shëndetësor.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur dhe paraqiti pranë Këshillit të Ministrave një dokument të strategjisë bazike sektoriale në Nëntor 2006, të shoqëruar nga një plan veprimi për hartimin dhe paraqitjen e Strategjisë së plotë të sektorit të Shëndetësisë, e parashikuar për t'u paraqitur në fillim të Prillit 2007.

Strategjia ndërsektoriale e mbrojtjes së konsumatorit

Ministria e Shëndetësisë, së bashku me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, përmes një grupi teknik të perbashket, ndodhet në fazën e konceptimit të strukturës dhe të ceshtjeve për t'u mbuluar në kuadrin e hartimit të dokumentit të Strategjisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.

Qëllime

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e synimeve të mëposhtme afatgjata:

- Një kuadër ligjor i plotë dhe modern, një sistem financimi i përshtatshëm, burime njerëzore të afta për t'ju përgjigjur nevojave të sistemit shëndetësor dhe një sistem informacioni i plotë në të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësor. Vendosija e pacientit në qendër të sistemit dhe rritja e rolit të tij.
- Akses më i mirë për shërbim shëndetësor parësor dhe ofrim i shërbimeve sipas normave dhe standardeve të përcaktuara. 100% e territorit të vendit të mbuluar me ambulancë deri në vitin 2015. Niveli i vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç i reduktuar në 10/1000 lindje të gjalla deri në vitin 2015 në krahasim me 20.1 në vitin 2001. Vdekshmëria amëtare në 2015 e reduktuar me 1/2 nga 2001 (22.7 vdekje/100 000 lindje të gjalla). 90% e popullsisë e edukuar mbi principet e kujdesit të shëndetit të gojës dhe 90% e grupmoshës 0-6 vjeç që do të përfitojnë nga fluorizimi deri në vitin 2015.
- Ofrim i modeleve bashkëkohore të menaxhimit të spitaleve deri në vitin 2015, gjë që presupozon sisteme të zhvilluara informacioni klinik dhe financiar si dhe ngritjen e sistemit të monitorimit i cili do të masë performancën spitalore dhe do të lejojë akreditimin e spitaleve. Ofrimi i shërbimeve të munguara.
- Sigurimi me vaksina dhe imunizimi me vaksina të detyrueshme, të mbajtur, përkatësisht, në nivelet 100% dhe mbi 95%. 0 raste me poliomelit dhe fruth. Vetëm raste të ralla dhe sporadike për rubeolën, difterinë dhe tetanozin. Seropozitiviteti i hepatit B tek fëmijët nën 1 vjeç, i ulur. Ulja, çdo vit, në masën 5%, e numrit të disa infeksioneve me burim ujë si rezultat i survejancës së sëmundjeve infektive dhe monitorimit të ujit të pijshëm. Laboratorët e shëndetit publik, të fuqizuar, totalisht, deri në vitin 2015.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e strukturës funksionale për një menaxhim të përshtatshëm të sistemit shëndetësor. Ruajtjen e integritetit të piramidës së shërbimeve shëndetësore duke ngritur 'autoritetet shëndetësore rajonale' në nivel qarku. Hartimin e dokumentave politikë dhe strategjikë dhe të planeve kombëtare të zhvillimit të sistemit shëndetësor. Akreditimin, inspektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sektorit.

3.2 SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e shërbimeve cilësore të kujdesit shëndetësor parësor të bazuar në komponentët e kujdesit kurativ, parandalues dhe të promovimit të shëndetit. Dhënien e autonomisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Hartimin e standardeve dhe normativave për ofrimin e KSHP.

3.3 SHËRBIMET E KUJDESIT DYTËSOR

Politika e këtij programi konsiston në: Ofrimin e Kujdesit Spitalor në të gjitha nivelet, për një akses më të mirë, cilësi të kënaqshme dhe menaxhim kosto-efektiv të këtij shërbimi. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve me anën e aplikimit të udhëzuesve të praktikës klinike, sistemit të akreditimit, trajnimit të personelit, vlerësimit të teknologjisë mjekësore dhe të performancës përmes treguesve përkatës.

3.4 SHËNDETI PUBLIK

Politika e këtij programi konsiston në: Ruajtjen, përmirësimin e shëndetit të popullatës, parandalimin e sëmundjeve infektive dhe kronike nëpërmjet sistemit të survejancës dhe zbatimit të masave dhe programeve përkatëse në fushën e shëndetit publik në bashkëpunim me shërbimin e mjekësisë familjare.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Objektivat e politikës

- Sistemi i informacionit për burimet njerëzore, i ngritur.
- 1% e stafit të profesionistëve të shëndetit të trajnuar nga Qendra e Formimit të Vazhdueshëm Mjekësor.
- 20% e stafit të MSH, i ngritur profesionalisht.
- Kategorizimi i ri për shërbimin infermieror, i ngritur.
- Hartimi i strategjisë për shtrirjen e praktikës së vlerësimit të performancës së spitaleve me anë të treguesve përkatës.
- Zbatimi i planit afatshkurtër të përafrimit të legjislacionit në sektor, me atë të BE.

Produktet që do të ofrohen:

- Manaxhimi i politikës sektoriale në MSH.
- 3% e nevojave për pajisje mjekësore të plotësuara.
- 2% e nevojave për pajisje mobilimi dhe zyre të plotësuara.
- 2% e nevojave për ambiente të rikonstruara, të plotësuara.
- 2 projekte të reja të ndërtuara për MSH.
- 2 projekte të mbështetura me kontribut e kosto lokale

4.2 SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR

Objektivat e politikës

- 10% e fshatrave, e mbuluar me ambulanca, çdo vit.
- 10% e QSH, të plotësuara me pajisje mjekësore, çdo vit.
- Rritje, në masën 10% e kontributit të buxhetit të MSH për sigurimin e kontraktivëve në shërbimet publike të planifikimit familjar.
- 4% e totalit të infrastrukturës së shërbimit stomatologjik publik, e përmirësuar
- 7% e popullsisë, e mbuluar me shërbim parandalues, çdo vit.
- Sistemi i informacionit në Kujdesin Shëndetësor Parësor, për 5 qarqe, i përfunduar.
- Trajnimi i mjekut të familjes në 5 qarqe.

Produktet që do të ofrohen:

- 4 500 000 vizita të kryera nga dhënësit e kujdesit shëndetësor parësor.
- 49 000 vizita obstetrike-gjinekologjike, të kryera në këshillimoret e grave.
- 935 000 vizita të kryera në këshillimoret e fëmijëve, për moshën 0-6 vjeç.
- 275 000 fëmijë deri në 18 vjeç, të trajtuar në shërbimin stomatologjik publik.
- 10% masa e financimit nga buxheti i shtetit për sigurimet shëndetësore.

- 200 000 kontribues në skemën e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore.
- 5 poliklinika të rehabilituara.
- Mjekë të trajnuar për planifikimin familjar.
- 10% e nevojave të plotësuara me pajisje mjekësore.
- 5% e nevojave për pajisje mobilimi dhe zyre të plotësuara.
- 15% e nevojave për ambiente të rikonstruara, të plotësuara.
- 2 projekte të mbështetura me TVSH & detyrim doganor.
- Sistemi i informacionit shëndetësor në qarkun e Beratit, i ngritur.

4.3 SHËRBIMET E KUJDESIT DYTËSOR

Objektivat e politikës

- Përmirësim i manaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare në spitalet universitare të Tiranës.
- Plotësimi, në masën 70%, i nevojave për medikamente për shërbimin e onkologjisë, hematologjisë, sipas skemave të miratuara të OBSH.
- 20% më shumë pacientë të trajtuar me hemodializë me të gjithë komponentët.
- Dyfishim i procedurave diagnostike dhe terapeutike (numri i ndërhyrjeve) në sëmundjet koronare.
- Plotësim, në masën 100%, i nevojave, me gjak të sigurtë.
- Plotësim, në masën 100% i nevojave për medikamente dhe materiale mjekimi në të gjithë spitalet e vendit.
- Përmirësimi i kushteve hoteliere në spitalet psikiatrike dhe trajtimin okupacional të të sëmurëve mendorë.
- Ngritja e tri shtëpive të mbrojtura, me nga 10 shtretër, për të sëmurët e shëndetit mendor në kuadër të procesit të de-institucionalizimit të spitaleve psikiatrikë.

Produktet që do të ofrohen:

- 65 000 pacientë të trajtuar në shërbimin e Kirurgjisë.
- 55 000 pacientë të trajtuar në shërbimin e Pediatriisë.
- 73 000 pacientë të trajtuar në shërbimin e Obstetrikë-Gjinekologjisë.
- Pajisje dhe infrastruktura spitalore të mirëmbajtura.
- Shërbime mbështetëse në spitalet e vendit, të siguruara.
- 80 000 pacientë të trajtuar në shërbimin e Patologjisë.
- 15% të nevojave të plotësuara, me ambiente të rikonstruara.
- Rehabilitimi dhe ndërtimi i Spitalit Shkodër i kryer.
- 5% e nevojave për pajisje mjekësore për spitalet, të plotësuara.
- 3 rikonstruksione: Spitali i Elbasanit, i Gramshit dhe i Librazhdit.
- Spitali i ri i Kavajës, i filluar ndërtimi.
- Spitali i ri në Durrës, zhvillimi i fazës tjetër të ndërtimit me vlerë 300 milion lekë.
- 5% e nevojave për pajisje mobilimi dhe zyre, të plotësuara.
- 15 trajnime të stafit të MSH dhe institucioneve të tjera.

- 1 klinike e sëmundjeve të brendshme, e rehabilituar.
- 4 projekte të mbështetura me kontribut e kosto lokale.
- 5 projekte të mbështetura me TVSH dhe detyrim doganor.
- Projekti i ndërtimit të spitalit për sëmundjet e brendshme në QSUT (CEB) (faza e parë) e përfunduar mbi 50%.

4.4 SHËNDETI PUBLIK

Objektivat e politikës

- Kalendari i vaksinimit, i zgjeruar me një vaksinë të re (Hib, hemofilus influenza).
- Lista e treguesve të shëndetit mjedisor, e përgatitur.
- Udhëzuesit e hetimit të shpërthimeve epidemiologjike, të përgatitur.
- Raportimi për sëmundje të caktuara, i përmirësuar, përpjestimi i rretheve që raportojnë në kohë dhe me cilësi, i rritur me 10% çdo vit.
- 10% e epidemiologëve, inspektorëve sanitarë dhe profesionistëve të shëndetit publik, të ngritur profesionalisht, në fushat përkatëse.

Produktet që do të ofrohen

- 50 000 fëmije të vaksinuar.
- 62 400 vrojtme të kryera për kontrollin e situatës epidemiologjike.
- 7 laboratorë mikrobiologjikë të mirëmbajtur.
- 1 raport përmbledhës i treguesve.
- Ruajtja e numrit të rasteve dhe prevalencës së ulët me HIV/AIDS (120 raste).
- 24 kontrole mjedisore (ujë, ajër, etj.).
- 15 aktivitete promovuese të shëndetit, çdo vit.
- 10% e nevojave për pajisje mjekësore, të plotësuara.
- 7% nevojave për pajisje mobilimi dhe zyre, të plotësuara.
- 8% nevojave për ambiente të rikonstruara, të plotësuara.

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore 600, 601	Mallra dhe sherbime 602	Subveconet 603	Te tjera transferte korrente 604, 605	Transferta per buxhetet familiare dhe individet 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikim, menaxhim, administrim	111	68	0	2	0	47	229
Shërbimet e kujdesit parësor	910	228	0	5 545	0	1 875	8 558
Shërbimet e kujdesit dytësor	5 372	4 560	0	0	0	2 983	12 916
Shëndeti publik	497	150	0	50	0	49	746
Total	6 890	5 006	0	5 598	0	4 955	22 449

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Planifikim, menaxhim, administrim		
Përqindja e stafit të profesionistëve të shëndetit të trajnuar		1%
Shërbimet e kujdesit parësor		
Përqindja e fshatrave të mbuluar me ambulanca		10%
Përqindja e qendrave shëndetësore e plotësuar me pajisje mjekësore		10%
Përqindja e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues		7%
Poliklinika të rehabilituara		5
Mjekë të trajnuar për planifikimin familjar		100
Vizita të kryera nga institucionet e kujdesit shëndetësor parësor		4 500 000
Vizita obstetrike-gjinekologjike të kryera në këshillimoret e grave		49 000
Vizita të kryera në këshillimoret e fëmijeve të moshës 0-6 vjeç		935 000
Fëmijë deri në 18 vjeç të trajtuar në shërbimin stomatologjik publik		275 000
Ngritje e shtëpive të mbrojtura për të sëmurët e shëndetit mendor		3
Shërbimet e kujdesit dytësor		
Pacientë të trajtuar në shërbimin e Kirurgjisë		65 000
Pacientë të trajtuar në shërbimin e Pediatriisë		55 000
Pacientë të trajtuar në shërbimin e Obstetrikë-Gjinekologjisë		73 000
Spitale të rikonstruktuar		6
Shëndeti publik		
Fëmije të vaksinuar		50 000
Laboratore mikrobiologjike të mirëmbajtur		7
Kontrolle mjedisore		24

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

- Projektligji “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”
- Projektligji “Për Urdhërin e infermier-mamive në Republikën e Shqipërisë”
- Projektligji “Për kujdesin shëndetësor”
- Projektligji “Për financimin e kujdesit shëndetësor dhe për Fondin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”
- Projektligji “Për pajisjet mjekësore”
- Projektligji “Për eliminimin e defiçiençës jodike nëpërmjet jodizimit të kripës”
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8167, datë 21.11.1996, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”, i ndryshuar

Aneks 2 Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë

Angazhimet sipas Programit të Qeverisë	Produktet
Krijimi i zyrave të informimit të publikut	Në fillim të vitit 2007 do të miratohet struktura e re e organizimit të instituciove drejtuese shëndetësore në nivel vendor dhe pjesë e këtyre drejtorive do të jenë edhe zyrat e informimit të publikut.
Decentralizimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor	Duke filluar nga janari 2007, shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor do të ofrohen nga dhënës me autonomi menaxheriale të cilët do të kontraktohen nga skema e sigurimeve shëndetësore. Çdo njësi e ofrimit të KSHP do të drejtohet nga një bord në nivel vendor me pjesëmarrje edhe të përfaqësuesve të qeverisjes vendore.
Investime të konsiderueshme në pajisje, ndërtime dhe burimet njerëzore në sektorin e shëndetësisë.	Ky objektivi mbështetet dhe shkon në të njëjtën linjë me programin e investimeve publike për sektorin e shëndetësisë për vitin 2007, me burime si buxhetin e shtetit dhe financimin e huaj.
Zgjerimi i sigurimeve të kujdesit shëndetësor në sektorin shëndetësor	Duke filluar nga janar 2007, skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor fillon financimin e gjithë shërbimeve të KSHP në nivel kombëtar. Gjatë vitit 2007, do të kryhet vlerësimi i kostove dhe shihet mundësia l financimit/rimbursimit prej ISKSH të disa egzaminimeve/shërbimeve si: hemodializa, koronarografia, rezonanca magnetike, CT Scanner etj.
Rajonalizimi dhe përqëndrimi i shërbimeve të kujdesit spitalor për të rritur disiplinën dhe përfshirjen e spitaleve në financimin prej skemës së sigurimeve të kujdesit shëndetësor	Në kuadrin e programit të investimeve publike për sektorin e shëndetësisë për vitin 2007, investimet në infrastrukturë do të fokusohen në spitalet rajonale duke ofruar përdorim më kosto-efektiv dhe eficient të burimeve. Gjatë vitit 2007 do të kryhet përlllogaritja dhe përcaktimi i kostos së shërbimeve spitalore si parakusht për financimin e spitaleve nga skema e sigurimeve shëndetësore.
Rritje të pagave në sektorin e shëndetësisë me 30-40%, brenda vitit 2007	Në vijim të rritjes së pagave të kryer, në masën 25% për personelin e mesëm shëndetësor dhe 20% për personelin e lartë gjatë vitit 2006, për vitin 2007, është parashikuar një rritje mesatare prej 20% për të gjithë punonjësit/ profesionistët e shëndetit.
Mbështetja e programeve të parandalimit të sëmundjeve: programi i vaksinimit / imunizimit, promovimi i shëndetit, kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm dhe i ajrit	Gjatë vitit 2007 do të mbështet programi i vaksinimit/ imunizimit duke mbuluar tërësisht koston e këtij programi, plotësimin e kalendarit me vaksinat e detyrueshme dhe përfshirjen e një vaksine të re (hemofilus influenza); mbajtja në nivele të larta e mbulesës vaksinale për të gjitha antigenet (mbi 95%). Do të vijojë të monitorohet me kujdes cilësia e ujit të pijshëm dhe e ajrit.
Zhvillimi i projekteve kombëtare për luftën kundër kancerit, sëmundjeve të zemrës dhe HIV/AIDS	Gjatë vitit 2007 do të vijojë zbatimi i projektit kombëtar për luftën kundër kancerit , në kuadrin e programit Interreg IIIA për fuqizimin e kapaciteteteve diagnostikuese dhe, njëkohësisht, do të rritet në 70% mbulimi i nevojave për medikamente të shërbimeve të onkologjisë dhe hematologjisë; dyfishim i numrit të egzaminimeve të koronarografisë; zbatimi i dy projekteve kombëtare për luftën kundër HIV/AIDS dhe tuberkulozit.
Nxitja e pjesëmarrjes së sektorit privat në shërbime të KSHP, shërbimin spitalor dhe shërbimet mbështetëse	Gjatë vitit 2007, ISKSH do të mund të kontraktojë edhe mjekë privatë për ofrimin e shërbimeve të KSHP. Do të stimulohet blerja e shërbimeve mbështetëse (kontraktimi nga jashtë), si kuzhina, lavanderia, hoteleria etj., nga sektori privat. Do të vlerësohet dhënia me konçesion i shërbimeve laboratorike në QSU Tiranë.
Reformimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore me qëllim rritjen e nivelit të mbledhjes së kontributeve përmes fuqizimit të kapaciteteve në Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor	Gjatë vitin 2007 do të studiohet dhe rivlerësohet politika e financimit të sigurimeve shëndetësore të detyrueshme, dhe, perfundimisht, do të vendoset nëse do të vijojë financimi i skemës përmes kontributeve apo prej sistemit të përgjithshëm të taksave.
Luftimi i monopoleve dhe konfliktit të interesave në tregun farmaceutik	Në këtë kuadër gjatë vitin 2007, do të kryhet një studim i transparencës në sektorin farmaceutik duke përdorur një instrument të hartuar nga OBSH, dhe do të zbatohen rekomandimet e dala prej tij.

<p>Fuqizimi i kontrollit dhe garantimi i cilësisë së barnave sipas standardeve Evropiane</p>	<p>Do të rritet numri i inspektorëve të barnave në Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave si një rritje e kapaciteteve të inspekimit të barnave, dhe do të vijojë procesi i përafrimit të legjislacionit në fushën e kontrollit të barnave me atë të BE.</p>
<p>Do të ofrohet shërbim i veçante dhe çmime më të ulëta për shërbimet shëndetësore dhe barnat për grupe sociale të veçanta si nënat dhe fëmijet, personat me aftësi të kufizuara, pensionistët</p>	<p>Në kuadrin e politikës për një listë të barnave të cilat rimbursohen nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, në listën e re e cila do të miratohet për vitin 2007 nga KM do të trajtohen në mënyrë të veçantë grupe të caktuara të popullsisë si pensionistët, personat me aftësi të kufizuara.</p>
<p>Rritje të pagave të punonjësve dhe profesionistëve të shëndetit dhe ngushtim të raportit të pagave, mes pagës më të lartë dhe asaj më të ulët në sektor, në 1:5 deri në 2009, rritje të pagës minimale në sektor</p>	<p>Gjatë vitit 2006, është kryer një rritje pagash prej 25% për personelin e mesëm shëndetësor dhe 20% për personelin e lartë, ndërkohë, që për vitin 2007, është parashikuar një rritje mesatare prej 20% për të gjithë punonjësit e shëndetit. Edhe për vitin 2007, është parashikuar një rritje e pagës minimale në sektorin e shëndetësisë.</p>
<p>Përmirësimi i aksesit ndaj shërbimeve të kujdesit, veçanërisht, në zonat më të varfëra</p>	<p>Në kuadrin e programit të investimeve publike për vitin 2007, është parashikuar një investim i konsiderueshëm në infrastrukturën e KSHP ndërkohë që alokimi i këtyre burimeve do të ketë objektiv përmirësimin e aksesit në KSHP në zonat e thella dhe më të varfëra.</p>

Aneks 3 Rezultate që lidhën me integrimin European

Plani kombëtar për zbatimin e MSA	Produktet
Pajisjet mjekësore. Krijimi i Njesisë së Menaxhimit të Standardeve.	Hartimi i strategjisë për pajisjet mjekësore Hartimi i projektligjit, "Për pajisjet mjekësore" duke përfshirë plotësisht Direktivën 90/385/EEC, Direktivën 93/42/EC dhe Direktivën 98/79/EC Hartimi i planit të veprimit për parashikimin e aktiviteteve dhe masave në kuadrin e zbatimit të ligjit
Barnat për përdorim njerëzor. Përbushja e kërkesave të MSA në drejtim të lëvizjes së lirë të mallrave dhe progres në fushën e transpozimit të direktivave të përafërimit të ri.	Përcaktimi i procedurave dhe formularëve për importimin e barnave të përgjithshme dhe të dhuruara Përcaktimi i procedurave të verifikimit të prodhimit dhe të shërbimit farmaceutik Riorganizimi i strukturës së kontrollit të barnave Ripërcaktimi i funksioneve të kontrollit të barnave sipas niveleve Njohja e fabrikuesve me rregullat e etiketimit të barnave dhe përcaktimi i kohës së zbatimit të rregullave Njohja e fabrikuesve me rregullat e praktikës së mirë të fabrikimit të barnave dhe vendosja e afateve për zbatimin Njoftimi i të interesuarve për klasifikimin e miratuar të barnave Njoftimi i të interesuarve për rregullat e reklamës dhe miratimi i formularëve të aplikimit për reklamë Organizimi i komiteteve të etikës mjekësore Rritja e kapaciteteve përmes trajnimit të anëtarëve për njohjen e legjislacionit dhe praktikës së mirë në provat klinike të barnave
Njohja reciproke e kualifikimeve për profesionet e lira. Lehtësimi i aktiviteteve profesionale të shtetasve shqiptarë dhe atyre të Komunitetit në Shqipëri dhe vendet respektive të Komunitetit	Studimi dhe identifikimi i normave komunitare për njohjen e kualifikimeve profesionale, për të sjellë në periudhën e mëvonshme harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE, në fushën e Shëndetësisë
Cilësia e ujit të pijshëm	Zbatimi i masave që rrjedhin nga rregullorja nr.4, date 10.5.1989 "për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave", e harmonizuar pjesërisht me Direktivën 76/768/EC "Për pishinat" Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm përmes uljes së normave maksimale të lejueshme të disa treguesve toksikë në ujin e pijshëm, në vijim të ndryshimeve në VKM nr.145, date 26.2.1998, "Për miratimin e rregullores higjieno sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm,.." si një harmonizim i pjesshem me Direktiva 80/778/EC, 98/83/EC
Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet	Përgatitja e procedurave dhe formularëve për import-eksportin e lëndëve radioaktive Përcaktimi i strukturës për zbatimin e planit të emergjencave radiologjike Riorganizimi i strukturave të kontrollit
Shëndeti publik. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor të shëndetit publik duke u përshtatur sipas standardeve të BE. Forcimi i kontrollit të sëmundjeve ngjitëse. Mbrojtja e shëndetit nga produktet e duhanit.	Krijimi i njesisë së hemovigjilencës Krijimi i Qendrës së Kontrollit të Jashtëm të cilësisë (gjaku) Përmirësimi i mirëmbajtjes së sistemit ALERT Përmirësimi i raportimit të HIV/AIDS dhe TB Vendosja e mbikqyrjes sindromike për sëmundjet e transmetueshme seksualisht Organizimi i tryezave të rumbullakta dhe fushata ndërgjegjësimi e sensibilizimi, lidhur me zbatimin e ligjit "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit" dhe i ligjit "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit"

Aneks 4 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
Planifikim, menaxhim, administrim	
Projekti statistikor i shërbimit spitalor	24
Projekte dhe master-plane për spitalet	3
Të tjera	21
Shërbimet e kujdesit parësor	
Investime për qendra shëndetësore të KSHP (Grant konkures për pushtetin vendor)	800
Rikonstruksione	20
Projekte-preventiva për objektet e DSH në rrethe	7
Supervizione-kolaudime	2
Blerje pajisje dhe aparatura mjekësore për DSH në rrethe	101
Të ardhurat dytësore	15
TVSH	30
Shërbimet e kujdesit dytesor	
Rikonstruksioni i Spitalit Psikiatrik të Elbasanit	40
Rikonstruksioni i ndërtësës së Spitalit të Lushnjës	50
Rikonstruksioni i brendshëm i ndërtësës kryesore të Spitalit të Gjirokastrës	42
Rikonstruksioni i ndërtësës së Spitalit të Krujës	51
Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i sistemit të ngohjes në Shërbimin e Pediatriisë në Spitalin e Vlorës	46
Rikonstruksioni i ndërtësës së Shërbimit të Psikiatriisë në QSU Tiranë	87
Rikonstruksioni i Shërbimit të Neurokirurgjisë në QSU Tiranë	80
Rikonstruksioni i Shërbimit të Pediatriisë në QSU Tiranë	50
Rikonstruksioni i ndërtësës së Spitalit të Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë	70
Rikonstruksioni i Shërbimit të Psikiatriisë në Spitalin e Shkodrës	10
Ndërtimi i dy shtëpive të mbrojtura për të sëmurët e shëndetit mendor	30
Ndërtimi i infrastrukturës fizike për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore në Spitalin e Sarandës	30
Ndërtime të reja dhe rikonstruksione të tjera	201
Projekt-preventiva për objektet spitalore	20
Supervizione dhe kolaudime për spitalet e vendit	21
Blerje pajisje dhe aparatura mjekësore për spitalet e vendit	431
Të ardhurat dytesore	15
TVSH dhe kosto lokale	520
Shëndeti publik	
Ndërtime të reja	15
Rikonstruksione të objekteve të shëndetit publik	16
Projekte për objektet e shëndetit publik	1
Supervizione dhe kolaudime	1
Blerje aparatura mjekësore Qendrat e Shëndetit Publik	12
Të ardhurat dytësore	4

Aneks 5 Projekte të ndihmës së huaj

Emri i projektit	Donatori	Kosto totale	Data e mbarimit
Planifikim, menaxhim, administrim			
Projekti për Modernizimin e Sektorit Shëndetësor	Banka Botërore	\$15.4 milion	Shtator 2010
Training Programme in Health Planning and Management (THPM)	Qeveria Zvicerane	CHF 0.5 milion	Shkurt 2008
Shërbimet e kujdesit parësor			
Improving primary health care in Albania	USAID	\$5.5 milion	Shtator 2009
Shërbimet e kujdesit dytësor			
Ndërtimi i Spitalit të Durrësit (Faza II)	Banka Islamike për Zhvillim	200 milion lekë	2008
Ndërtimi i Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme (Faza I sipas masterplanit) në QSU Tiranë	Banka e Këshillit të Evropës	650 milion lekë	2008
Ndërtimi i Spitalit të ri të Kavajës	Banka Islamike për Zhvillim dhe Fondi OPEC	300 milion lekë	2009
Strengthening the management and maintenance system for the Albanian health services	Qeveria Suedeze	€0.85 milion	2007
Hospital equipment management and maintenance	Qeveria Suedeze	SEK 30 milion	2009

